

VENDIM
Nr. 23, datë 16.2.2016

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “KISI-BIO-ENERGJI” SHPK, PËR LËNIE SI GARANCI HIPOTEKORE PRANË RAIFFEISEN BANK, TË ASETEVE QË DISPONON

Në mbështetje të neneve 16; 44; 110 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenet 7 dhe 11, të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.2.2016, pasi shqyrtoi kërkesën për lënien si garanci hipotekore të aseteve të shoqërisë “KISI-BIO-Energji” sh.p.k. pranë Raiffeisen Bank, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “KISI-BIO-Energji” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pikat 1.1 dhe 1.2 (ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte).
- Neni 7, pika 1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h” (ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte).
- Neni 7, pikat 2, 3, 4 dhe 5 (ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte).
- Me vendimin nr. 162, datë 28.12.2015, Bordi i ERE-s ka vendosur fillimin e procedurave për lënien peng. Gjatë hetimit nga ana e ERE-s është konstatuar se subjekti ka hyrë në marrëveshje me bankën, për të lënë asetet që disponon si garanci hipotekore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “KISI-BIO-Energji” sh.p.k., për lënie si garanci hipotekore pranë Raiffeisen Bank, të aseteve që disponon, si më poshtë:

- a) Gjenerator elektrik, turbinë, panele elektrike, nënstacion elektrik.
- b) Pasuri e paluajtshme e HEC “Kacni”, me sipërfaqe 356 m², reregjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme (ZRPP) Dibër, me numër pasurie 19 ND.
- c) Vepra e marrjes, baseni i presionit, linja elektrike të HEC “Kacni”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti